



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 18**

**Datë: 14. 03. 2020. Ora: 16:30**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

**Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare**

**Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Eshref Vishi, ( Ibrahim Selmanaj, Nenad Rikalo, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani ).**

**SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit**

**Përkthyes: Argjina Misini**

**Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.**

---

**RENDI I DITËS**

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:
2. Kërkesë për Presidentin e Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi për shtyrjen e datës së Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme të 15 marsit 2020, për Kryetar Komune në Komunën e Podujevës.
3. Të ndryshme !

---

**1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**

**Valdete Daka:** Të nderuar anëtar të KQZ – së, ju njoftoj se pas masave të ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me situatën epidemiologjike me COVID – 19, gjatë ditës së sotme, më konkretisht para gjysmë ore, ( e shtunë: 14.03.2020), në KQZ kemi pranuar Rekomandimin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe të Komitetit për Monitorimin e Sëmundjeve Ngjitëse të Ministrisë së Shëndetësisë për pezullimin e përkohshëm të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Komunën e Podujevës, e të cilat, ishin paraparë të mbahen këtë të diele, që domethënë nesër, më 15 mars 2020.

Rrethanat epidemiologjike që po zhvillohen me shpejtësi, si në Kosovë ashtu edhe jashtë vendit – në përmasa globale, na detyrojnë që të marrim hapa për shtyrjen e këtyre zgjedhjeve. Ky veprim yni, sidomos pas rekomandimit në fjalë, është krejtësisht në interes të shëndetit të qytetarëve tanë.

Të nderuar anëtarë të KQZ-së të pranishëm në këtë mbledhje të jashtëzakonshme !

Ne, kemi përpiluar një Kërkesë që, do t'ia dërgojmë urgjentisht Presidentit për shtyrjen e këtyre zgjedhjeve. Konsideroj se, jeni të pajtimit me hapin që po e ndërmarrim në rrethanat e krijuara. Ju njoftoj se, i kam kontaktuar edhe me anëtarët e tjerë që natyrisht, nuk mund të jenë prezent, tani me ne, në mbledhje për shkak të situatës së krijuar! Por, edhe ata, janë të pajtimit që zgjedhjet të shtyhen dhe për këtë të kërkojmë edhe zyrtarisht nga Presidenti shtyrjen e datës së këtyre zgjedhjeve deri në një afat të pa caktuar.

Anëtarët e KQZ-së miratuan këtë Kërkesë.